

## Mobiliteti

Treni dhe autobusi

Biçikleta / në këmbë

Vetura / motoçikleta

Patentë shoferi

# Treni dhe autobusi

Në Zvicër komunikacioni publik është i organizuar shumë mirë. Praktikisht çdo vendbanim është pothuajse i arritshëm me trena ose autobusa. Mjetet e komunikacionit janë të përpikta dhe nisen në afate kohore të rregullta.

## Komunikacioni publik

Në Zvicër komunikacioni publik (ÖV) zë një vend shumë të rëndësishëm. Pasi që pothuajse çdo vendbanim mund të arrihet disa herë brenda orës, shumë udhëtarë e shfrytëzojnë trenin ose autobusin. Edhe pse udhëtimet janë relativisht të shtrenjta, ekzistojnë mundësi të ndryshme për të kursyer para. Kështu ia vlenë që të blehet një abonement ose një biletë e lirë. Me abonementin relativisht të volitshëm gjysmë çmimi (Halbtaxabo) paguhet p.sh. në tërë Zvicrën vetëm gjysma e çmimit.

## Biletat dhe abonementet

Kush dëshiron të udhëtoj me tren, duhet së pari ta pres biletën (Billett). Biletën nuk mund ta preni (bleni) në tren. Në autobusë është e rregulluar ndryshueshëm. Në çdo stacion të trenit dhe në shumicën e stacioneve për ndalje të autobusëve gjenden automatët për blerjen e biletave, në stacionet e mëdha të trenave ka edhe sportele me shërbim. Biletat mund të blehen edhe online ose përmes handyt. Për personat të cilët udhëtojnë shpesh ka abonemente të ndryshme. Këto mund ti bleni për distanca të caktuara, regjione të veçanta ose për tërë Rrjetin e Komunikacionit të Zvicrës (Generalabonnement). Fëmijët deri 6 vjeç mund të udhëtojnë falas. Deri në moshën 16 vjeç fëmijët mund të udhëtojnë së bashku me prindërt ose gjyshërit e tyre gati falas, nëse keni biletë junior ose për nipërit dhe mbesat (Junior-oder Enkelkarte). Informatat në lidhje me biletat dhe abonementet mund të merren pranë Federatës së Trenave të Zvicrës (SBB) ose pranë ndërmarrjeve të autobusave.

## Kantoni Glarus Ostwind

Unioni Tarifor *Ostwind ju ofron tarifa speciale* brenda territorit të Kantonit Glarus për biletat, abonementet dhe biletat ditore. Territori është i ndarë në shumë zona. Biletat apo abonementet janë të vlefshme në tren dhe autobusë brenda zonave të paguara. Kushdo që udhëton jashtë këtij territori duhet ta nxjerr (blejë) një biletë tjetër.

## **Biletat ditore të Komunave**

Kush e planifikon një udhëtim të gjatë mbrenda Zvicrës, mundet në shumë Komuna ta pres (blej) një biletë ditore (Gemeindetageskarte) me çmim të volitshëm. Kjo ofertë është e kufizuar, për këtë arsye rezervimi duhet të bëhet mjaftueshëm herët. Informata për këtë ju ofrojnë administratat e Komunave.

## **Linjat e natës**

Në fundëjavë në Kantonin Glarus qarkullojnë autobusa ose trena edhe natën vonë .  
Kujdes: Në linjat e natës duhet të paguhet shtesa speciale ndaj biletës.

## **Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/treni-dhe-autobusi](http://www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/treni-dhe-autobusi)

## Biçikleta / në këmbë

Falë rrjetit të organizuar mirë të rrugicave për biçikleta, ngasja e biçikletave në Kantonin Glarus është shumë e këndshme. Shumë të punësuar e shfrytëzojnë biçikletën për të shkuar në punë. Për këmbësore ose shtegëtarë ekzistojnë rrugica speciale për shtegëtim.

### Në këmbë ose me biçikletë (Velo) përgjatë rrugëtimit

Kantoni Glarus është atraktiv për ngasësit e biçikletave dhe këmbësorët dhe veçanërisht relativisht i sigurtë. Për distanca të shkurtëra shunë persona heqin dorë nga veturat. Në shumë vendbanime ekzistojnë rrugicat apo korsitë speciale për biçikleta. Te vendkalimet për këmbësorë, këmbësorët kanë gjithëmonë përparësi kundrejt çdo automjeti (përveç kur kalimi i rrugës është i rregulluar me semafor). Kantoni Glarus ofron shumë rrugica të bukura për shëtitje dhe shtegtim, të cilat mund të eksploroni gjatë kohës së lirë. Rrugët për shtegtim janë të shënuara me udhërrëfyes me ngjyrë të verdhë.

### Rregullat për ngasësit e biçikletave

Për ngasjen e biçikletës në Zvicër nuk është e nevojshme ndonjë leje speciale dhe s'ka nevojë për provim. Në përgjithësi vlejnë të njëjtat rregulla si për ngasësit e automjeteve. Nëse në dispozicion janë rrugicat ose korsitë speciale për biçikleta duhet të shfrytëzohen ato. Biçikleta duhet të jetë teknikisht në rregull për komunikacion (dy frena të mirë, zilja, reflektorët para dhe prapa dhe në pedale, dritat para dhe prapa). Bartja e helmetës nuk është e detyrueshme, mirëpo është e preferueshme. Ngasësit e biçikletave do të duhej patjetër ta lidhin sigurimin për zhdëmtim të detyrueshëm, sepse ata mbajnë përgjegjësi për dëmet e shkaktuara (ndaj personave dhe gjësendeve).

### Mësimi për ngasjen e biçikletës

Kush dëshiron ta mësojë ngasjen e biçikletës, mundet ta vijoj një kurs. Kurset ofrohen në të gjitha regjionet e kantonin Glarus prej shoqatës pro biçikletës (Pro Velo). Për emigrantët në disa komuna ofrohen kurse speciale. Biçikleta të përdorura me çmim të volitshëm mund të blehen në tregjet për biçikleta (Velobörsen).

### Transportimi i biçikletave

Kush dëshiron ta marr me vete biçikletën në tren ose autobus, për këtë i duhet biletë speciale. Nuk është e mundshme që gjithmonë dhe gjithkund të merret biçikleta me vete. Pjesërisht duhet më parë të rezervohet një vend në tren.

**Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)**

[www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/bicikleta--me-kembe](http://www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/bicikleta--me-kembe)

## Vetura / motoçikleta

Në Zvicër rrjeti rrugor është i shprëndarë dhe organizuar mirë. Shfrytëzimi i shumicës së rrugëve është pa taksa. Rregullave të komunikacionit ju kushtohet shumë rëndësi. Nëse këto nuk respektohen gjobat janë të larta.

### Rregullat e komunikacionit

Rregullave të komunikacionit në Zvicër ngasësit e automjeteve ju kushtojnë shumë rëndësi. Në krahasim me vendet e tjera gjobat janë shumë të larta. Në rast të shkeljeve të rënda ndaj rregullave mundet të merret patenta e shoferit.

Disa rregulla të rëndësishme:

- Shpejtësia më e madhe e lejuar mbrenda vendbanimit: 50 km/h; jashtë vendbanimit: 80 km/h, rrugë automobilistike: 100 km/h, Autostrada: 120 km/h
- Në autostradë tejkalimi nga ana e djathtë është i ndaluar
- Dritat duhet të jenë të ndezura edhe gjatë ditës
- Të gjithë personat në veturë duhet të lidhen me rripin e sigurisë
- Fëmijët duhet ulen në ulëse për fëmijë (deri në 12 vjeç ose deri në gjatësi prej 150 cm)
- Gjatë ngasjes telefonimi është i lejuar vetëm me pajisje për folje të lirë
- Ngasja nën ndikimin e alkoholit ose drogës është e dënueshme (kufiri i promilës 0.5)
- Këmbësorët në vendkalimin për këmbësorë kanë gjithmonë përparësi (përveç nëse kalimi është i rregulluar me semafor)

### Taksat për rrugë

Rrugët financohen prej, Federatës, Kantoneve dhe Komunave. Shfrytëzimi i rrugëve është pa taksa. Përrjashtim bëjnë autostradat: Kush dëshiron t'i shfrytëzoj autostradat duhet çdo vit ta blej taksën për autostradë (Vignette). Ato duhet të ngjiten në xhamin e parë të veturës. Taksat për autostrada (Vignette) gjinden në pompat e benzinës në posta ose në zyrat për qarkullim rrugor.

## Sigurimi

Në Zvicër lejohet përdorimi vetëm i automjeteve të cilat janë të siguruara. Sigurimi i automjetit për detyrim zhdëmtimi (Motorfahrzeug-Haftpflichtversicherung) ofrohet nga sigurime të ndryshme private. Sigurimi paguan për dëmet ndaj gjësendeve dhe personave të cilat shkaktohen me automjet. Për dëmet në automjetin privat ka sigurime vullnetare shtesë kasko (Kaskoversicherung). Kujdes: Nëse dikush sillet me pakujdesi të tepëruar, sigurimi, mvarësisht prej rrethanave, mund të mospaguaj (p.sh ngasja nën ndikim të alkoholit ose drogës). Sigurimi i automjetit për detyrim zhdëmtimi nuk është i integruar në sigurimin për zhdëmtim privat (Privat-Haftpflichtversicherung).

## Importi i një automjeti

Kush dëshiron që një automjet ta importoj për kohë të pacaktuar në Zvicër duhet ta lajmëroj atë në doganë për zhdoganim. Automjeti duhet t'i nënshtrohet kontrollit teknik. Juve ju nevojitet sigurimi i automjetit për detyrim zhdëmtimi, libreza zvicerane të automjetit dhe tabela me numra të Zvicrës. Informata të sakëta ju jep zyra e qarkullimit rrugor të Kantonit Glarus (Strassenverkehrsamt des Kantons Glarus).

## Shfrytëzimi i automjetit nga më shumë persona

Carsharing është shfrytëzimi i organizuar i përbashkët të një ose më shumë automjeteve. Automjetet e një organizate "Carsharing-Organisation" janë të vendosura në parkingje të përhershme të marrura me qira dhe duhet të rezervohen paraprakisht. Vendqëndrimet ndodhen shpeshë në pikat lidhëse të qarkullimit publik (p.sh. pranë stacionave të trenit). Për dallim nga marrja me qira e automjetit, përdorimi i automjetit është i mundur edhe për kohë të shkurtër (p.sh. për disa orë).

## Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/vetura--motocikleta](http://www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/vetura--motocikleta)

## Patentë shoferi

Në Zvicër ngasja e veturës ose e motoçikletës lejohet vetëm me patentë shoferi të vlefshme. Patentshoferët e huaj mbas vendosjes në Zvicër duhet të shndërrohen në patentë shoferi të Zvicrës.

### Patentë shoferët e huaja

Kush vendoset në Zvicër dhe posedon një patentë shoferi (Führerausweis) duhet këtë mbrenda 12 muajsh ta shndërroj në patentë shoferi të Zvicrës. Për këtë duhet të shtrohet kërkesë në Zyrën Kantonale të Qarkullimit Rrugor (Strassenverkehrsamt). Mverëshisht nga Shteti ku është lëshuar patentë shoferi, vlejnë rregulla të tjera për shëndrrim. Mundet me qenë që provimi praktik është i nevojshëm ose që shoferja ose shoferi ta kaloj provimin teorik të Zvicrës. Zyra Kantonale për Qarkullim Rrugor Glarus jep informata të tjera.

### Provimi për patentë shoferi

Në Zvicër për ta marrë patentë shoferin është i nevojshëm provimi. Provimi për patentë shoferi përbëhet nga pjesa teorike dhe ajo praktike. Në provim mund të hyjnë personat mbi 18 vjeç. Për parakushtet dhe rrjedhjen e saktë ju informon Zyra Kantonale për Qarkullim Rrugor Glarus. Për ngasjen e kamionit, autobusit dhe taksit janë të nevojshme provime tëspeciale.

### Më shumë informacione (link, adresa, broshura, fletushka)

[www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/patentshoferi](http://www.hallo-glarus.ch/sq/mobiliteti/patentshoferi)